



PAGA MINIMALE & EFEKTET E SAJ NË PUNESIM

Si një vend në zhvillim, Kosova vuan nga niveli i ulët i edukimit, punëtorë të pakualifikuar dhe shkalla e lartë të papunësisë. Me një lëvizje të stilolapsit qeveria pati vendosur pagën minimale në vitin 2011. A ishte ky vendim i mirë apo i keq dhe se si paga minimale mund të ndikojë në punësim është në qendër të këtij dokumenti.

Të drejtat e autorit © 2017.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pasazheve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të Lëvizjes FOL.

Përkrahur
nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Cooperation Office Kosovo

EYE Enhancing Youth
Employment

Ky punim është përgatitur në kornizën e projektit “FOL Hapur” që mbështetet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim, dhe implementohet nga “Helvetas Swiss Cooperation” dhe MDA. Përmbajtja e këtij punimi është krejtësisht përgjegjësi vetëm e Lëvizjes FOL, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si diçka që reflekton pozicionin e Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim ose të Departamentit Zviceran për marrëdhënie të jashtme.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	3
Shprehjet dhe definicionet	4
Hyrje	5
Çka është paga minimale?	7
Si llogaritet paga minimale?	7
Paga minimale në Kosovë	9
Analiza	12
Vendimi i nxituar dhe prapanik	12
Nevoja për pagën minimale në Kosovë	13
Çfarë thonë teoritë?	13
Kosova	14
Paga minimale dhe të rinjtë – a mundet paga minimale të pengoj arsimin e lartë?	15
Paga minimale e nivelit të lartë apo e nivelit të ultë, kush humb dhe kush përfiton?	18
A duhet ta eliminojmë pagën minimale?	20
Pamje e përgjithshme ekonomike – a ka hapësirë për ndryshim të pagës së tanishme minimale?	21
Përfundim	22

Përmbledhje ekzekutive

Kjo përmbledhje ka për qëllim që të përdoret si punim diskutimi në çështje specifike, domethënë pagën minimale.

Paga minimale është mjet i politikës qeveritare që të ndërhyjë në tregun e punës me caktimin e nivelit minimal të pagave që secili person i punësuar duhet ta marr. Në botë shumë shtete kanë përdorur këtë politikë për të vendosur pagën minimale të parashikuar me ligj ose pagën minimale sektoriale me qëllim të sigurimit të minimumit të standardit jetësor për punonjësit.

Në vitin 2011 Kosova ka vendosur pagën minimale të parashikuar me ligj që zbatohet në shkallë vendi, përderisa gjithashtu ka negociuar kontratën kolektive me sindikatat për pagën minimale dhe të spektrit të gjerë të përfitimeve tjera për punonjësit.

Ky punim diskuton se si ka ardhur ky vendim, a ka qenë publiku i përfshirë në diskutim paraprak dhe cilat janë efektet e saj pozitive dhe negative për punësim, e veçanërisht tek të rinjtë.

Punimi ka për qëllim të shërbej si dokument diskutimi dhe inkurajohet hulumtim i mëtutjeshëm para vendosjes së çfarëdo niveli të ri të pagës minimale në të ardhmen. Punimi konstaton se vendosja e pagës minimale kërkon paraprakisht hulumtim gjithëpërfshirës akademik, duke njohur specifikat e shtetit dhe aspektet tjera të rëndësishme. Gjithashtu sjell hipoteza të forta që sfidojnë besimin se paga minimale duhet të rritet në mënyrë progresive. Kjo është për shkak të aspekteve teorike të bazuara në fakte që paga minimale e nivelit të lartë mundet të ndikojë në mënyrë negative tek punësimi prandaj edhe sugjeron që duhet të ekzistojnë tregues të unifikuar që marrin parasysh performacën e përgjithshme ekonomike para ndryshimit të pagës së tanishme minimale.

Shprehjet dhe definicionet

Paga minimale – shuma minimale e pagesës që punëdhënësi duhet ti paguaj rrogëtarëve për punën e kryer gjatë periudhës së dhënë, e cila nuk mund të zvogëlohet me kontratë kolektive ose me kontratë individuale (ONP).

Paga minimale e parashikuar me ligj – paga minimale e caktuar dhe e rregulluar me ligj e cila zbatohet në shkallë vendi në të gjithë sektorët, nën të cilën punëtorët nuk mund të paguhen.

Paga minimale sektoriale – paga minimale që negociohet në secilin sektor dhe mund të jetë e ndryshme për secilin sektor.

Paga minimale për orë – paga minimale që është caktuar për orë që jo domosdoshmërisht reflekton pagën minimale mujore.

Paga minimale mujore – paga minimale që pavarësisht prej orarit të punës duhet të arrihet për ata/ato që kanë një punë të përhershme (me orar të plotë).

Grupet e cenueshme – të rinjtë, punonjësit pa përgatitje profesionale.

Të rinjtë – paraqiten si punonjës të moshës 15–24 vjeçare.

Pa përgatitje profesionale – janë ata/ato që kanë të kryer vetëm shkollën fillore (“pa shkollë” janë anashkaluar).

Me përgatitje të mesme profesionale – janë ata/ato që kanë kryer jo më tepër se shkollën e mesme.

Me përgatitje profesionale – janë ata/ato që kanë kryer fakultetin.

Hyrje

Paga minimale është ndoshta një prej politikave më të diskutuara qeveritare. Varësisht prej sfondit ideologjik të partive politike, disa parti zotohen në rritjen e pagës minimale dhe të tjerat për ta ulur atë. Zakonisht, ato të spektrit të majtë që e përkrahin drejtësinë sociale e përkrahin pagën minimale si obligim moral, përderisa ato të spektrit të djathtë, që preferojnë treg të lirë me pak ose pa ndërhyrje nga qeveria preferojnë pagë minimale të nivelit të ultë ku secili e merr atë që e meriton.

Në fillim të vitit 1900 me revolucionin industrial që shpiu në zhvillimin e fabrikave të shkallës së lartë të prodhimit dhe që kërkoi fuqi të madhe punëtore, gjithashtu filloi shfrytëzimi i fuqisë punëtore.

Në disa shtete, fuqia punëtore filloi të organizohej në sindikata. Në Suedi, e cila ka sistemin më të avancuar të mirëqenies në botë¹, sindikatat filluan të paraqiteshin në vitin 1870. Suedia ishte në mes të atyre shteteve që karakterizohej me marrëveshjet (kontratat) kolektive thjesht duke lartësuar obligimet morale. (Gunnarsson, Lilja Hanson, & Åkerlund, 2006).

Në të vërtetë, në çështjen thelbësore të pagës minimale qëndron ideja e ndërhyrjes së qeverisë në tregun e punës për të mbrojtur ata/ato që janë më së tepërmi të cenueshëm si dhe ata në vijën e varfërisë, ndonëse përveç kësaj kjo është menduar ti kontribuoj kohezionit (tërheqjes reciproke) më të madh shoqërorë dhe drejtësisë sociale. Pothuajse të gjithë ekonomistët pajtohen që ata/ato që janë objekt i pagës minimale janë ata/ato pagat e të cilëve janë afër minimumit, që zakonisht janë fuqi punëtore pa përgatitje profesionale dhe të rinjtë që mund të shfrytëzohen në tregun e lirë pa ndërhyrje nga ana e qeverisë.

Neumark vëren se paga minimale ka qenë element thelbësor i politikës publike për më tepër se një shekull dhe se si paga minimale ndikon në punësim ka qenë çështja më e spikatur në lidhje me vlerësimin e politikave të pagës minimale dhe në të vërtetë një prej temave më të hulumtuara në ekonomi (Neumark & Wascher, 2008).

Sikurse që do ta paraqesim më poshtë, debati për pagën minimale ende nuk është kryer në mes të studiusve dhe është pjesë e debatit elektoral në mes të politikanëve, por sot pothuajse 90% e shteteve të botës e kanë përvetësuar standardin për pagën minimale, duke e bërë të njohur me ligj

¹<http://www.oecdbetterlifeindex.org/#>

që zbatohet në shkallë vendi, ose me orar të punës (në rastin e SHBA-ve) ose me marrëveshje kolektive në secilin sektor (rasti i shteteve nordike).

Kosova ka miratuar ligjin për pagën minimale të parashikuar me ligj në vitin 2011. Çfarë kanë qenë efektet e një page të këtillë minimale të parashikuar me ligj për ekonominë – e posaçërisht të rinjtë, është në thelb të kësaj përmbledhjeje.

Teoritë kryesore nuk pajtohen me pagën minimale të nivelit të lartë dhe studiuesit e të gjitha vendeve zakonisht pajtohen që paga minimale e nivelit të lartë e parashikuar me ligj mund të ketë efekte negative në punësim dhe rritjen ekonomike ndërsa i dëmton ata/ato që paga minimale tenton ti mbrojë – punëtorët me përgatitje të ultë profesionale dhe rininë.

Gjatë marrjes së vendimit për pagën minimale, duket se Kosova nuk ka marr parasysh asnjë teori apo literaturë dhe në mungesë të shkrimeve akademike dhe/ose dokumenteve strategjike qeveritare, vështirë është të dihet se cilat kanë qenë argumentet për të vendosur për pagën minimale të parashikuar me ligj në nivelet që është vendosur.

Sipas raportit vjetor nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), pagat në sektorin privat kanë ndryshuar në baza vjetore që nga vendimi i qeverisë së vitit 2011 për ta paraqitur pagën minimale të parashikuar me ligj. Të gjitha sektorët e kanë ngritur pagën e tyre mesatare përderisa paga minimale ka mbetur e paprekur. Ngritja e pagës mesatare në sektorin privat na jep shenja paralajmëruese që ngritja në minimumin e tanishëm të parashikuar me ligj nuk do të ketë efekte negative.

Megjithatë, kjo përmbledhje, në mungesë të të dhënave zyrtare për pagat minimale prej secilit sektor, dështon në dhënien e sugjerimeve të forta në lidhje me ngritjen domethënëse të pagës minimale aktuale. Nëse sektorët e mëdhenj siç janë tekstili, janë të gatshëm të ofrojnë vetëm paga të minimumit aktual se sa ndonjë ngritje që do të lidhet me hap të ngadalshëm të punësimit ose me papunësi të mundshme.

Kjo përmbledhje është e organizuar si në vijim; në fillim paraqet disa shprehje dhe definicione, jep definicionin e pagës minimale dhe si llogaritet ajo dhe pastaj vazhdon me analizë të pagës minimale në Kosovë. Nxjerr në pah faktet dhe shifrat aktuale, përfshirë argumentet që lidhen me pagën minimale në Kosovë, strukturën ligjore dhe indikatorët ekonomik. I analizon efektet e pagës aktuale minimale në ekonomi

(punësim) në lidhje me punëtorët me përgatitje të ultë profesionale me theks të veçantë tek të rinjtë.

Çka është paga minimale?

Sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP), paga minimale përkufizohet si *“shuma minimale e pagesës (shpërblimit) që punëdhënësi duhet ti paguajë rrogetarëve për punën e kryer gjatë periudhës së dhënë kohore, e cila nuk mund të zvogëlohet me marrëveshjen kolektive ose me kontratë individuale”* (International Labour Organization, 2016)

Sipas Arpaia, dhe të tjerët, paga minimale vendos një nivel të të ardhurave të fituara me punë dhe në këtë mënyrë, mund të zvogëlojë rrezikun e varfërisë në punë e cila është lidhur me pagesë të ultë. Gjithashtu mund të zvogëlojë pabarazinë e pagave, posaçërisht në fund të shpërndarjes së pagave. (Arpaia, Cardoso, Kiss, Van Herck, & Vandeplas, 2017).

Paga minimale gjithashtu është mjet publik për qeveritë që të ndërhyjnë në tregun e punës me qëllim të mbrojtjes së grupeve më të cenueshme, zakonisht punëtorëve pa përgatitje profesionale, me qëllim të ofrimit të minimumit të standardit jetësor për punonjësit.

Si llogaritet paga minimale?

Në përgjithësi, nuk ka formulë standarde që përdoret në llogaritjen dhe përcaktimin e pagës minimale e cila do të përdorej në tërë botën, zakonisht më tepër negociohet dhe është e ndryshme në shtete të ndryshme.

Në Mbretërinë e Bashkuar ekziston udhëzuesi prej 52 faqeve i titulluar *“Paga Minimale Kombëtare dhe Paga Jetësore Kombëtare – Duke llogaritur pagën minimale, duke treguar komplikimin e jo vetëm të vendosjes por gjithashtu duke llogaritur pagën minimale.”*

Atë që e thekson literatura është se faktorët vijues duhet të merren parasysh me rastin e përcaktimit të pagës minimale:

- a) nevojat e punonjësve dhe e familjeve të tyre;
- b) kërkesa për pagën jetësore,
- c) përshtatja e pagës përballë Indeksit të Çmimit të Konsumatorit (CPI),
- d) kostoja e jetesës dhe e ndryshimeve,
- e) nevojat e punonjësve dhe e familjeve të tyre dhe

f) pagat e krahasueshme dhe të ardhurat.

Shënim nga përkthyesi: nën a) dhe e) janë te njëjta –njëra duhet të largohet.

Në shumicën e rasteve, paga minimale është kompromisi në mes të palëve të interesuara, duke përfshirë të gjithë partnerët social (shoqëror).

Në BE, vlerat e propozuara të pagës minimale bëhen sipas indeksit të Kaitz-it, e cila është 50% e mesatares kombëtare.

Indeksi i Kaitz-it është një variabël e re e pagës minimale që mat pagën minimale të parashikuar me ligj si përqindje e pagës mesatare, shkallën e saj nominale të pagës minimale nga paga mesatare.

Ky indeks (tregues) propozon paga të ndryshme për grupe të caktuara, ku disa sektore që kanë prodhimtari më të lartë do të paguheshin më tepër.

Sa i përket Kosovës, e cila ka pagë minimale të parashikuar me ligj, Indeksi Kaitz mund të jetë i dobishëm, sepse synon që fundi, numëruesi (llogaritësi) i indeksit të jetë i njëjtë për të gjithë punëdhënësit. Duke e kthyer sistemin e pagave në sektorial, qeveria sipas këtij indeksi mundet gjithashtu të bëjë pagën minimale që varet nga mosha. Pasi që në Kosovë të rinjtë përmbajnë përqindje të lartë të fuqisë punëtore, indeksi i Kaitz-it mund të jetë i dobishëm në përcaktimin e pagës minimale për moshë dhe merita.

$$Kaitz_{it} = \frac{PagaMinSektorale_{it}}{Mesatare(PagaShtetërore_{it})}$$

Paga minimale në Kosovë

Sipas Bankës Botërore, Kosova është shtet me të ardhura të ulta të nivelit të mesëm. Banka Botërore thekson zhvillimin e ngadalshëm ekonomik në Kosovë por pohon se një zhvillim i tillë nuk ka qenë i mjaftueshëm që në mënyrë të mjaftueshme të zvogëloj shkallën e lartë të papunësisë; të ofroj punë formale veçanërisht për femra dhe të rinj; ose të ndryshoj trendin e emigrimit të një shkalle të lartë. Modeli i zhvillimit aktual mbështetet fuqishëm në remitenca (para të dërguara) për fuqizimin e konsumit vendor.

“Strategjia aktuale e zhvillimit të Kosovës duhet të fokusohet në adresimin e bllokimit të infrastrukturës në energji, duke krijuar një mjedis më të favorshëm për zhvillimin e sektorit privat, pajisjen e popullatës së re me shkathtësi të duhura që të jenë më tërheqës për punëdhënësit, dhe ndërtimi i qeverisjes dhe i sundimit të ligjit që të mbledh në tërësi përfitimet e integritetit në BE, të zgjidh (lëshoj) të ardhurat e prodhimit dhe të krijoj vende pune kualitative si dhe përfshirje”².

Banka Botërore në asnjë fjali nuk e përmend pagën minimale si politikë që Kosova duhet ta ndjek me qëllim të stimulimit të punësimit apo të stimulimit të zhvillimit ekonomik.

Megjithatë, në vitin 2011 me vendim të qeverisë, Kosova ka vendosur pagën minimale të parashikuar me ligj³⁴. Sipas atij vendimi, paga minimale është detyruese në shkallë vendi dhe janë vetëm dy karakteristika dalluese lidhur me moshën, ata/ato të moshës deri në 35 vjet do të pranojnë pagën minimale në shumën 130 Euro, dhe ata/ato që janë mbi moshën 35 – 65, do të pranojnë pagën minimale në shumën 170 Euro.

Baza ligjore për këtë vendim është thënë të jetë Kushtetuta e Kosovës, neni 92 paragrafi 4 dhe neni 93 paragrafi 4.

Sipas ligjit të punës, faktorët që janë marrë parasysh për caktimin e pagës minimale në Kosovë janë si në vijim:

- 1) Çmimet e kostos së jetesës
- 2) Shkalla e papunësisë

²<http://www.worldbank.org/en/country/kosovo/overview>

³http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_33-te_te_Qeverise_2011.pdf

⁴<https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10274>

- 3) Situata e përgjithshme në tregun e punës
- 4) Prodhimtaria dhe niveli i konkurrencës

Sipas udhëzimit administrativ Nr. 09/2013, në caktimin e pagës minimale duhet të merret parasysh paga mesatare në sektorin privat⁵.

Sipas udhëzimit administrativ, kushtet për ndryshimin e pagës minimale janë si në vijim:

1. Kur inflacioni i përgjithshëm i IÇK (Indeksi i Çmimeve të Konsumatorit)⁶ (Mesatarja 12-mujore prej tetorit deri në tetor) është mbi 2%
2. Kur shkalla e këmbimit real efektiv (Mesatarja 12-mujore prej tetorit deri në tetor), e botuar nga Banka Qendore e Kosovës është më e ultë se sa 0.5%, dhe

Një varg i kriterëve pak më ndryshe të vendosur nga një dokument tjetër ligjërishit detyrues i quajtur Kontrata Kolektive në Kosovë e nxjerrë nga Organizatat e Punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Bizneseve), Organizata e Punëtorëve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës) dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale) si anëtare të Këshillit Ekonomiko-Social (KES):

1. Çmimet e kostos së jetesës;
2. Nevojat e punonjësve dhe e familjeve të tyre;
3. Standardi i jetesës së punonjësve dhe
4. Niveli i zhvillimit ekonomik.

Edhe pse kriteret janë detyruese për qeverinë dhe për të gjitha palët e përfshira, ende nuk është e qartë nëse Këshilli Ekonomiko-Social (KES) do t'i merr parasysh kriteret e mësipërme kur vendos për çfarëdo ndryshimi në të ardhmen për pagën minimale aktuale.

Sipas nenit 71 të Kontratës Kolektive, palët e përfshira në kontratë janë të obliguara të implementojnë dhe të monitorojnë dispozitat e Kontratës së tanishme Kolektive.

Por Neni 90 i Ligjit të Punës e len këtë në diskrecion të kompanive që të vendosin nëse ata/ato do të marrin përgjegjësinë apo jo të zbatimit të dispozitave të Kontratës së Përgjithshme Kolektive.

⁵<https://qzk.rks-qov.net/ActDetail.aspx?ActID=10274>

⁶ consumer price index

Kontrata kolektive në Kosovë

Çka është definicioni i kontratës kolektive?

Neni 3 i Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës thekson se shprehja “kontratë kolektive” domethënë marrëveshje në mes të organizatave të punëdhënësve dhe organizatave të punësuarve që i rregullojnë këto të drejta, detyra dhe përgjegjësi që dalin nga marrëdhënia e punës në bazë të marrëveshjes së arritur.

Sa nivele të ujdlive ekzistojnë?

Kontrata kolektive mund të arrihet në tri nivele: në nivel kombëtar, në nivel dege dhe në nivel të ndërmarrjes.

Ujdia kolektive vendoset lirshëm apo është detyruese?

Vendoset lirshëm.

Kush mund të jenë palë në kontratën kolektive?

Organizata e punëdhënësve dhe përfaqësuesit e tyre dhe Organizata e punësuarve ose, në rastet ku nuk ekzistojnë organizata të tilla, marrëveshja mund të arrihet prej përfaqësuesve të punësuarve.

Fushëveprimi i kontratës kolektive?

Dispozitat e kontratës janë detyruese për palët e Marrëveshjes, në sektorin privat, publik dhe atë shtetëror (në nivelin e përgjithshëm, nivelin e degës dhe në nivelin e kompanisë).

Cilat vende të punës, profesione ose degë përfshihen?

Të gjitha punët, profesionet dhe degët përveç marrëdhënieve të punës me misionet ndërkombëtare, misionet diplomatike dhe konsulare të shteteve të huaja, Prania e Ushtrisë Ndërkombëtare e themeluar në Republikën e Kosovës sipas Propozimit Gjithpërfshirës për Vendosjen e Statusit dhe të Organizatave Qeveritare Ndërkombëtare.

Pagat minimale?

Kontrata kolektive përmban vetëm kushtet për caktimin e pagës minimale, përderisa Qeveria e Republikës së Kosovës, në dhjetor të secilit vit kalendarik, cakton pagën minimale në Kosovë për vitin e ardhshëm.

Orari i punës?	Po
Pushimi?	Po.
Puna jashtë orarit dhe pagat fikse?	Puna jashtë orarit Po, pagat fikse Jo
Puna me orar të shkurtuar?	Duhet të përcaktohet në nivel të Degës ose Kompanisë.
Minimumi i pushimit dhe maksimumi i orarit të punës?	Po
Të drejtat e të punësuarit që është në pushim mjekësor?	Ndërprerja e performancës, e kontratës së punës? Po.
Disciplina?	Po
Trajnim profesional	Jo

Mjetet juridike kundër shkeljes së kontratës kolektive ?

Kontrata kolektive nuk ka dispozita që e rregullojnë shkeljen e kontratës.

Cili trup apo autoritet i përcakton shkeljet?

Nuk specifikohet në Kontratën Kolektive.

A ka ndonjë politikë që e promovon ujdinë kolektive dhe ligjin kolektiv kontraktor?

Jo.

A ka ndonjë problem lidhur me marrëdhënien në mes të kontratës së punës dhe kontratës kolektive?

Jo , sepe kontrata e punës duhet të jetë në pajtim me Kontratën Kolektive dhe me Ligjin e Punës.

A vepron lidhja në mes të ligjit dhe kontratave kolektive në favor të punësuarve (parimi i favorizimit, efekti i shtrëngimit (ratchet effect)), ose a lejon kushte më pak të favorshme ?

Neni 4 i Ligjit të Punës thekson që dispozitat e Kontratës Kolektive, Aktit të Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontrata e Punës duhet të jenë në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Gjithashtu, Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj, por mund të përmbajë dispozita me të cilat përcaktohen më shumë të drejta dhe kushte të favorshme nga të drejtat dhe kushtet e përcaktuara me Ligjin e Punës.

#Kontratakolektive #Nukëshhtënfuqi #Nukëshhtëdetyruesepërbizneset

Analiza

Vendimi i nxituar dhe prapanik

Procesi i vendosje së pagës minimale është bërë shpejt e lehtë në vitin 2011. Sot askush nuk mund të gjej një dokument të vetëm nga grupi punues qeveritar ose nga komisioni parlamentar ose ndonjë trup tjetër institucional që dëshmon që diskutim paraprak është bërë para kryeministrit të atëhershëm, Hashim Thaçi.

Edhe sot është si enigmë se si ka ardhur ky vendim dhe si ka ndodh që askush nuk është konsultuar. Shumë pyetje mbasin për tu përgjigjur. Pse vlerat 130 dhe 170 janë konsideruar si paga minimale të mira? Cilat llogaritje janë bërë ose çfarë formule është përdorur për vendosje apo ka qenë vendim arbitrar prej zyrtarëve qeveritarë?

Cilat baza janë përdorur për ndarje në dy grupe të moshave dhe pse një grup ishte deri në moshën 35 vjeçare? A është kjo ndarje diskriminuese duke marr parasysh faktin që shumica e fuqisë punëtore është brenda moshës 35 vjeçare? Kjo dhe shumë pyetje të tjera mbeten pa përgjigje.

Fatkeqësisht, ne nuk do të jemi në gjendje të japim përgjigje në kaq shumë pyetje, në fakt ne do të shtojmë më tepër pyetje, por duket se është kohë e përshtatshme që tani ti adresojmë pyetjet të tilla dhe të fillojmë të kërkojmë përgjigje që janë tepër të vonuara.

Të fillojmë nga kushti i moshës. Vendimi ka caktuar pagën minimale të nivelit të ultë prej 130 EURO për moshën vendimtare, pra, nën moshën 35 vjeçare. E para, nuk është e qartë prej cilës moshë njëri/njëra duhet të pranojë pagën minimale prej 130 EURO. A ka të drejtë adoleshenti, që është ende në shkollë të mesme, në pagën minimale prej 130 EURO? A zbatohet paga minimale tek ata/ato që kryejnë praktikë me pagesë, tek ata në programin trajnues, tek ata që janë duke studiuar dhe që kërkojnë punë me orar të shkurtuar? A i inkurajon paga minimale të rinjtë që ti braktisin studimet dhe të zgjedhin pagën minimale?

Ne nuk e dimë këtë pasi që nuk ka pasur asnjë debat të çfarëdo niveli të shoqërisë për koston dhe përfitimet e pagës minimale. Ne e dimë si fakt që mosha rinore është në mes moshës 15-24⁷vjeçare siç është vendosur

⁷http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Liqji_03-L-145_per_Fugizim_dhe_Piesemarrje_te_Rinise.pdf

me ligjin për të rinjtë. Vendimi nuk është i qartë se si pagat janë caktuar dhe duket se ka qenë më tepër për të shënuar pikë politike se sa për të zgjedhur problemin.

Nevoja për pagën minimale në Kosovë

Çfarë thonë teoritë?

Për nga pikëpamja teorike, vendosja e pagës minimale kërkon analiza paraprake për efektet e saj në ekonomi. Kryesisht janë dy rryma të teorive që shkojnë në favor dhe kundër pagës minimale.

Njëra është liberalizmi/neoliberalizmi dhe Kejnezianizmi dhe periudha post Kejnezianiste (Keynesianism and post-Keynesianism). Për Palley-in, neoliberalizmi kërkon që tregjet e lira nuk do të lejojnë faktorët e çmuar (vlefshëm) të prodhimit –përfshirë fuqinë punëtore – të humbet (shpërdoret). Në vend të saj, çmimet do të rregullohen për të siguruar që kërkesa është e disponueshme (e gatshme) dhe që të gjithë faktorët janë shfrytëzuar (Palley, 2004). Neoliberalistët besojnë që ekonomia edhe pse është në rënie, përfundimisht do të vihet në rregull. Kur ekonomia është tatëpjetë, atëherë çmimet do të bijnë në pikën ku qytetarët do të jenë në gjendje të paguajnë. Ata parashikojnë që paga do të ngritët nëse ata në anën e furnizuesit – punëdhënësi- ballafaqohen me kërkesë të ultë si rezultat të vendeve të punës që paguhen pak. (Neumark & Wascher, Minimum Wages and Employment, 2007) (Neumark & Wascher, Minimum Wages, 2008) (Cunningham, 2007) (Palley, 2004).

Ata të periudhës post Kejneziane argumentojnë që shpërndarja e të ardhurave varet në mënyrë domethënëse nga faktorët institucional. Ata argumentojnë që ngritja në paga reale shpie në ngritjen e konsumit, e cila siç edhe duhet ngrit kërkesën për fuqi punëtore dhe e zvogëlon papunësinë. Si rezultat, rritja në pagën minimale dhe në pagën mesatare do të ketë efektet përfituese në punësim dhe në ekonominë e përgjithshme (Lavoie, 2006).

Modeli neoliberal, Kejnezian (neo-Kejnezian) dhe neoklasik të gjithë pajtohen që kur paga minimale vendoset mbi pagën ekuilibruese atëherë efektet e punësimit do të jenë negative. Dhe nëse paga minimale ngritët shumë lart mund të shkaktoj edhe papunësi për shkak se do t'i kushtoj tepër shumë firmave (kompanive) që ta mbajnë numrin e mëparshëm të punonjësve.

Kosova

Banka Botërore e fut në listë Kosovën me të ardhura të ulta të nivelit të mesëm me shkallë të papunësisë prej 27%. Me këtë shkallë të papunësisë shtrohet pyetja nëse është fare e nevojshme paga minimale. Nëse paga minimale e tanishme (*nëse ne e largojmë kushtin diskriminues të moshës*) vendoset në atë nivel që është nën ekuilibër (*vlera e tregut*⁸) atëherë nuk ka kurrfarë efekti në punësim.

Por ne nuk e dimë vlerën e vërtetë të vendeve të punës për shkak të përmasave jashtëzakonisht të mëdha të ekonomisë joformale. Shumica e punonjësve me përgatitje të ultë profesionale dhe të rinjtë supozohet se punojnë në sektorin joformal. Kjo do të thotë që së paku një kriter – paga mesatare në sektorin privat siç është dhënë prej Administratës Tatimore të Kosovës - nuk është e saktë.

Prandaj, në mungesë të dhënave të besueshme, deri në një nivel në këtë përmbledhje, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë pagën mesatare në sektorë të ndryshëm pasi që nuk ka statistika zyrtare ose studime lidhur me punonjësit me përgatitje të ultë profesionale dhe të rinjtë. Në shtojcën A, të bashkangjitur në këtë raport ne japim statistikën kryesore sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, ku është dhënë paga mesatare në sektorin privat, por ne nuk e dimë pagën minimale që është paguar prej sektorëve dhe numrin e njerëzve që janë të gatshëm që të punojnë për atë minimum.

Literatura sugjeron që punonjësit me përgatitje të ultë profesionale ka më tepër mundësi të gjenden në sektoret ku nuk kërkohet fare apo kërkohet minimumi i përgatitjes profesionale.

Nga këndvështrimi neoliberal, rritja e pagës minimale përderisa papunësia është e lartë është një politikë e gabueshme. Supozimi është që nëse ata/ato në anën kërkuese – punonjësit – janë të gatshëm të pranojnë punë nën pagën minimale, pastaj duke e vendosur pagën minimale në ekuilibrin e mësipërm, qeveria është duke mbajtur lart shkallën e papunësisë, ose së paku nuk është duke e inkurajuar punësimin. Neoliberalët parashohin që paga do të rritet nëse ata në anën e furnizuesit – punëdhënësit – ballafaqohen me kërkesë të ultë si rezultat i vendeve të punës që paguhen pak.

⁸ Paga të cilën tregu është i gatshëm ta paguaj

Pasi që shumica e teorive nuk e përkrah pagën minimale të nivelit të lartë, atëherë ne duhet ta qartësojmë për nivelin e tanishëm të pagës minimale për Kosovën.

Nga këndvështrimi i periudhës pas Kejneziane, rritja e pagës minimale do të rezultonte në më tepër konsum dhe si rezultat në më tepër shpenzim e cila do të sillte kërkesë për produkte, por edhe teoricienët e periudhës pas Kejneziane besojnë që me rritjen mbi ekuilibër do të ndikoj negativisht në punonjësit me përgatitje të ultë profesionale dhe posaçërisht tek të rinjtë.

Paga minimale dhe të rinjtë – a mundet paga minimale të pengoj arsimin e lartë?

Të dytë Kellerman dhe Neumark (Kellermann, 2017) (Neumark & Wascher, Minimum Wages, 2008) argumentojnë që rritja e pagës minimale vendos nxitje të larta për të rinjtë që të braktisin sistemin arsimor ose të braktisin programin profesional trajnues të paguar pak me qëllim që të fitojnë minimumin e nivelit më të lartë me punësim me orar të plotë dhe që paga minimale inkurajon të rinjtë të braktisin shkollën, pasi që ata do të mund të gjejnë vend pune që paguhet mirë pa e pas përgatitjen e nevojshme profesionale.

Paga minimale në Kosovë nuk konsiderohet të jetë shumë e lartë me qëllim që t'i shtyjë të rinjtë të braktisin arsimin. Megjithatë, vendimi i qeverisë i vitit 2011 për të vendosur pagën minimale nuk i ka marr parasysh efektet që paga minimale do të kishte në arsimin e të rinjve. Siç e theksuam më lart, askush nuk mund të gjej një dokument të vetëm që është vendosur në diskutim me publikun lidhur me nevojën dhe nivelin e drejtë të pagës minimale dhe të efekteve të saja pozitive apo negative.

Pasi që nuk ka pasur diskutim publik e as diskutim akademik, dikush mund të thotë që vendimi i qeverisë për vendosjen e pagës minimale nuk është bazuar në analiza shkencore dhe hulumtime dhe duket më tepër si vendim i menjëhershëm për të shënuar pikë politike.

Kjo përmbledhje dështon të dëshmojë efektet reale të pagës minimale tek të rinjtë⁹ për shkak të formatit të saj dhe për arsye se nuk statistika të mëparshme dhe të tashme zyrtare për tregun e punës me fokus tek të

⁹ Sipas ligjit nr..03/L-45, rinia është mosha në mes viteve 15-24

rinjtë dhe gjithashtu ka mungesë të studimeve (vështirimeve të përgjithshme).

Ky punim ka për qëllim të shërbejë si dokument diskutues dhe inkurajohet që edhe më tutje të hulumtoj para se të vendoset çfarëdo niveli i pagës minimale në të ardhmen.

Nga këndvështrimi teorik, për të ditur efektet e pagës së tanishme minimale për punësimin e të rinjve dhe efektet e pagës minimale në arsimin e të rinjve ne duhet ta dimë nëse paga e tanishme minimale në nivel më të lartë se sa ekuilibri i tregut.

Nëse paga minimale prej 130 Eurove bie më ultë se vlera e tregut atëherë nuk pritet që të ketë ndonjë efekt negativ në punësimin e të rinjve, por nëse është më e lartë se ekuilibri atëherë pritet të ketë efekte negative.

Sipas studimit “*Vlerësimi i tregut për sektorin e Ndërtimtarisë*” të vitit 2015, në vitin 2013 rroga mesatare në sektorin e ndërtimtarisë është vlerësuar të jetë 388 Euro, rroga e 4-të më e lartë në mes të gjithë sektorëve tjerë.

TAB 14. 5: PAGA (BRUTO) MESATARE MUJORE NË SEKTORËT EKONOMIK SIPAS VITEVE 2008-2014

		(€)						
Sektorët	Përshkrimi i sektorëve ekonomike	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
B	Xehitari dhe gurëthyes	348	357	382	383	561	461	470
C	Prodhim	228	228	227	248	275	332	326
D	Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	486	469	555	557	564	608	610
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	197	197	210	214	219	360	361
F	Ndërtimtari	216	221	227	275	360	319	329
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve, motoçikletave	218	207	206	252	274	305	305
H	Transporti dhe magazinimi	257	260	262	263	263	366	379
I	Akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	208	217	221	220	269	266	265
J	Informacion dhe komunikim	776	783	792	829	852	707	708
L,M,N,R,S	Aktivitete të shërbimeve tjera	235	238	255	302	334	273	293
	Gjithsej	275	272	280	309	338	349	352

(Strategy & Development, 2015, p. 2).

Nëse paga në sektorin e ndërtimtarisë do të merrej si ekuilibër i tregut atëherë çfarëdo rritje që bie nën këtë ekuilibër nuk pritet të ketë efekt negativ në punësimin e të rinjve.

Por kjo e shtrun pyetjen, a është kjo mesatare përfaqësuese? Çfarë do të jetë me sektorët tjerë?

Siç mund ta shohim në tabelën 1, pothuajse të gjithë sektorët privat të ekonomisë kanë pasur rritje të pagës mesatare. Por tabela ende nuk na tregon se si është llogaritur mesatarja. Nëse shumica e njerëzve do të

Tabela 1. Pagat mesatare sektoriale mujore në sektorin privat 2008 – 2014. Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

punonte për pagë minimale atëherë çfarëdo rritje e parashikuar me ligj do të ndikonte menjëherë tek ata punonjës.

Nga këndvështrimi teorik, caktimi i pagës minimale të parashikuar me ligj në nivel kombëtar, duhet të merr punët që paguhen më së paku në tregun e punës. Alternativë e kësaj është të ketë pagë minimale sektoriale.

Në fakt, nëse marrim shtetet nordike si shembull, atëherë paga minimale nuk duhet të jetë e parashikuar me ligj por më mirë të rregullohet në secilin sektor përmes kontratave të veçanta kolektive.

Paga minimale sektoriale do të siguronte pagë minimale më të mirë dhe më të drejtë që do ta merrte në konsideratë nivelin arsimor të secilit person, prodhimtarinë e sektorit dhe përvojën e punonjësve.

Sa i përket punësimit të rinjve, na nevojiten të dhëna në sektorët e veçantë ku ne supozojmë që do të punësohen të rinjtë. Sipas “*Vlerësimit të tregut për sektorin e ndërtimtarisë*” (Strategy & Development, 2015), të rinjtë përfaqësojnë 27% të fuqisë së përgjithshme punëtore në sektorin e ndërtimtarisë por nuk ka të dhëna për sektorët tjerë, posaçërisht ato ku besohet që të rinjtë të jenë më tepër të punësuar, sektorë të këtyllë do të ishin sektori i kamerierëve, furnizim ushqimi, ushqimi i shpejtë, supermarketet dhe fabrikat e tekstilit.

Për të u marrë si indikatorë për pagën minimale, shifrat më lartë duhet të jenë zyrtare. Indikatorët prej EYE¹⁰ bazohen në studimin e Strategy & Development Consulting (Konsulenca e Strategjisë dhe e Zhvillimit) dhe nuk janë statistika zyrtare prej Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Të rinjtë e punësuar në sektorin e ndërtimtarisë besohet të jenë pjesë e ekonomisë joformale që do të thotë se ata/ato nuk paguajnë tatim në të ardhura dhe nuk janë subjekt as i pagës minimale e as të përfitimeve të ofruara nga ligji i punës.

Nëse puna në sektorin joformal është me përqindje më të lartë në mes të rinjve dhe tabela e pagave gjithashtu më e lartë, kjo do të ishte tregues për rritjen e pagës minimale. Siç sugjeron Kuninghemi (Cunningham, 2007), paga minimale e nivelit më të lartë në sektorin joformal është

¹⁰ Enhancing Youth Employment

gjithashtu detyruese në sektorin formal. Kjo është për arsye se sektori formal i rrit pagat që të tërheq punonjësit për të punuar në sektorin formal.

Nëse kemi rast të tillë, caktimi i pagës minimale në nivel shumë të ultë, përderisa tregu është i gatshëm të paguaj më tepër, kjo e lë mundësinë për punëdhënësit që të t'i shmangen kontributeve sociale dhe tatimeve.

Siç e vërejnë Van Klaveren dhe të tjerët *“Qeveritë shpesh kanë interes në mbajtjen e nivelit të caktuar të pagës minimale, pasi që paga minimale në një numër të profesioneve ka bazë minimale për tatim. Qeveritë kanë interes të mëtjetshëm fiskal për mbajtjen e ngurtë (solide) të pagës minimale, sepse në shtetet e Evropës Qendrore dhe të Evropës Lindore disa punëdhënësit i deklarojnë punonjësit e tyre në pagën minimale dhe pastaj ja paguajnë pjesën tjetër të pagës në “zarfe” në mënyrë që ti shmangen kontributeve të sigurisë sociale.”*

Nga këndvështrimi kur madhësia e sektorit joformal është domethënëse si në Kosovë duhet të studiohet dhe të mblidhen më tepër prova me qëllim të arritjes së sugjerimeve më të forta.

Sipas disa zyrtarëve qeveritarë, të cilët nuk dëshiruan të identifikohen në raport, ekzistojnë punonjës (të kontraktuar prej kompanive private) që punojnë në sektorin publik për pagën minimale prej 130 Eurove¹¹. Pasi që sektori joformal është i gatshëm të paguaj paga më të larta, është me rëndësi të bëhen më tepër hulumtime dhe të qartësohet për punonjësit që janë të gatshëm të punojnë me paga të ulta në sektorin formal. Vetëm nëse kemi të bëjmë me pagat e llojit “zarfit” ku punëdhënësit paguajnë minimumin dhe ja japin pjesën tjetër në zarf për shkak të shmangies së kontributeve sociale.

Paga minimale e nivelit të lartë apo e nivelit të ultë, kush humb dhe kush përfiton?

Kunningham (Cunningham) vëren se përkundër efekteve të vogla pozitive tek ata që fitojnë afër pagës minimale (pra, me përgatitje të ultë profesionale dhe të rinjtë), në shtetet me paga minimale të nivelit relativisht të lartë, paga minimale mund të rrisë pagat e atyre që paguhen më tepër, mund të rrisë papunësinë në mes të varfërve, mund të shkaktojë varfëri më të madhe në mes të varfërve, dhe mund të shkaktojë rritje të pabarazisë në të ardhurat e fuqisë punëtore në familje. Kështu, përderisa

¹¹ Në mes tyre janë rojet që ruajnë institucionet dhe ata/ato që punojnë në sektorin e pastrimit.

paga minimale e nivelit të lartë mund të shërbejë si objektivë e drejtësisë sociale, caktimi i saj tepër lart mund të ketë efekt të kundërt (Cunningham, 2007, p. 3).

Qëllimi i pagave minimale është përmirësimi i aftësive të individëve për përkrahjen e familjeve të tyre dhe shmangia e mirëqenies (Ellwood, 1988), por modeli i literaturës së furnizimit dhe kërkesës parashikon që përfitimi i pagës së tillë vjen në shpenzim të niveleve të ulta të punësimit (Brown, 1988).

Përfundimi i tillë është në pajtim me parashikimet e neoliberalëve që kanë vërejtur se ndryshimet e pagës minimale të parashikuara me ligj ndikojnë vetëm tek ata punonjës që paga e tyre fillestare është afër minimumit (Alaniz, Gindling, & Terrell, 2011).

Mendimi i përgjithshëm është se për të parë se kush humb dhe kush fiton prej pagës minimale të nivelit të lartë, njëri duhet të fokusohet në studimet mbi rezultatet e tregut të punës në sektorët specifik të ekonomisë që tentojnë të paguajnë punonjësit afër minimumit.

Shpesh, paga minimale perceptohet si çështje e lidhur me shtetet e zhvilluara. Kjo është për shkak të faktit që shumë shtete të zhvilluara kanë paga të ulta si rezultat i përqindjes së madhe të njerëzve që janë të gatshëm të punojnë për pagë minimale të nivelit të ultë prandaj edhe caktimi dhe rritja e pagës minimale mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë tek punëtorët dhe standardit të tyre jetësor. Por paga minimale nuk mund të shihet nga thjerrëzat e shteteve të zhvilluara dhe si politikë që ndihmon vetëm të varfëritë. Siç na mëson shembulli nordik, paga minimale mund të caktohet për secilin sektor veçmas dhe të kategorizohet sipas aftësive dhe moshës ashtu që të hyrat dhe të ardhurat e reflektojnë nivelin arsimor, prodhimtarinë e sektorit dhe përvojën e punonjësve.

Megjithëse shtetet e zhvilluara që luftojnë me punonjësit me përgatitje të ultë profesionale për shkak të sistemit të dobët arsimor dhe pagat e ulta janë të nevojshme më së tepërmi për pagat minimale të parashikuara me ligj dhe pagat minimale sektoriale, në mënyrë paradoksale pothuajse të gjitha teoritë janë kundër pagave minimale në shtete të këtylla. Pothuajse të gjitha teoritë parashohin rënie të kërkesës për punonjës me përgatitje të ultë profesionale si përgjigje në rritjen e pagës minimale dhe sipas Pejxh (Page) dhe të tjerët pasi që radhët e mirëqenies zakonisht janë të nxituara me humbjen e punësimit, rënia tek mundësitë e punës mund të shpie në rritjen e numrit të marrësve të ndihmës sociale (Page, Spetz, &

Millar, 2005). Prandaj, rritja e pagës minimale jo vetë që shkakton papunësi por mundet edhe të shtojë numrin e marrësve të ndihmës sociale.

A duhet ta eliminojmë pagën minimale?

Kjo pyetje është paraqitur nga Neumark dhe Wascher në studimin e tyre të gjatë lidhur me pagën minimale. Përfundimet e tyre lënë të kuptojnë që paga minimale e nivelit të lartë do të vë kostot në punonjësit me përgatitje të ultë profesionale dhe të familjeve me të ardhura të ulta pa shpërndarjen e përfitimeve që mënjanojnë këto kosto. Për shembull, zvogëlimi i pagës minimale prej nivelit që tashmë është më ultë se paga e tregut për punonjësit me përgatitje të ultë profesionale mund të pritet që të ketë pak ose aspak ndikim në punësim ose në të ardhura sepse vetëm disa individë mund të ndikoheshin nga ky ndryshim. Kështu, Neumark dhe Wascher janë skeptik që eliminimi i pagës minimale do të mund, siç argumentojnë jo-ekonomistët, të shpie tek rënia e shtrirë në paga deri në nivele të ekzistencës. Në shumicën e tregjeve të punës, pagat caktohen nga furnizimi i fuqisë punëtore dhe kërkesa për fuqi punëtore, dhe jo nga ofertat e pagave të pafrenuara të punëdhënësve.

Marginean dhe të tjerët në anën tjetër, nga hulumtimi i tyre në Rumani s'kanë gjetur asnjë dëshmi që rritja e pagës minimale shkakton papunësi ose punësim. Ajo pyet: Pra, pse ne do të shqetësoheshim për pagën minimale? Ekziston paradoksi: edhe paga minimale është kufizim i vendosur në tregun e punës por efektet janë në tregjet tjera. Ajo argumenton se kur ne e ngrisim pagën minimale, asgjë nuk ndodh sa i përket punësimit dhe papunësisë, prandaj ne duhet të mendojmë se ekzistojnë pjesë të tjera të ekonomisë dhe tregje tjera që e përkrahin këtë efekt. (Marginean & Stefania Chenic, 2013).

Marginean do ta ketë lënë anash çështjen e ekuilibrit, e cila është shumë e rëndësishme, posaçërisht për vendet e zhvilluara. Danziger, argumenton që ekziston lidhje e ngushtë në mes të dëshirës për të ngritë pagën minimale për përmirësimin e mirëqenies së punëtorëve me pagë të ultë dhe papërkulshmërisë (ngurtësisë) së kërkesës për fuqinë e tyre punuese. Motivimi për shumë studime empirike për kërkesën për fuqi punuese me pagë të ultë është dëshira për vlerësimin e efikasitetit të shkallës së pagës minimale të nxjerrë me ligj për luftimin e varfërisë. (Danziger, 2007)

Paga minimale nuk mund të shihet prej thjerrëzave të punësimit/papunësisë por sikurse Gunarson dhe të tjerët (Gunnarsson, Lilja Hanson, & Åkerlund, 2006) sugjerojnë, është gjithashtu obligim moral të mbrohen ata/ato që janë më të cenueshëm dhe që mund të shfrytëzohen nga tregu.

Prandaj, vendosja apo eliminimi i pagës minimale është gjithashtu çështje e qasjes politike dhe sociale. Në shumë shtete, paga minimale është çështje politike për zgjedhje (elektorat) ku kandidatët dhe partitë politike ndahen.

Në Kosovë, ne nuk kemi parë që paga minimale të bëhet çështje elektorale pasi që shumica e partive politike nuk kanë qëndrim të qartë ideologjik për të gjitha çështjet dhe ata preferojnë të lënë të paprekura çështjet e rëndësishme që ndajnë elektoratin për arsye që të mos humbin votuesit e tyre.

Pamje e përgjithshme ekonomike – a ka hapësirë për ndryshim të pagës së tanishme minimale?

Të bashkangjitur në këtë raport janë indikatorët ekonomik që tregojnë performancën e ekonomisë që nga viti 2011 kur është vendosur për pagën minimale. Çfarëdo debati për nevojën e ndryshimit të pagës së tanishme minimale do të duhej të bazohej në disa tregues të besueshëm ekonomik. Indikatorët për ndryshim të pagës minimale siç kërkohet prej ligjit janë të përcaktuar në ligjin e punës, Urdhëresën Administrative Nr. 09/2013 dhe në Kontratën Kolektive¹².

Nga grafika në *shtojcën A* mund të përfundohet që paga e tanishme minimale do të mund të ndryshohej nëse indikatorët e përcaktuar në ligjin e punës, Urdhëresën Administrative Nr. 09/2013² dhe Kontratën Kolektive do të merreshin seriozisht.

Grafiket tregojnë se përderisa indikatorët ekonomik kanë qenë pak a shumë të qëndrueshëm në shtatë vitet e kaluara, paga mesatare neto në

¹² Ne e pyetëm Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), nëse Kontrata e Përgjithshme Kolektive është pezulluar apo jo. Në përgjigjen e tyre, ata thanë se Kontrata kurrë nuk është pezulluar edhe pse Oda Ekonomike e Kosovës, si pjesë e Këshillit Ekonomiko-Social, ka kërkuar të diskutohet për sektorin privat, por për palët tjera të Këshillit (*domethënë Qeveria dhe BSPK-ja*) kjo ishte e papranueshme, prandaj edhe Kontrata është ende në fuqi. Ata gjithashtu thanë se Kontrata nuk është implementuar në tërësi në sektorin privat. Këshilli është në pritje të konstituivit të Qeverisë së Kosovës për të nënshkruar Kontratën e re.

administratën publike pothuajse është dyfishuar, duket se është zbutur shkalla e papunësisë dhe që paga mesatare në sektorin privat është ngritur.

Pasi që të tri këto dokumente parashikojnë indikatorë të ndryshëm për konsiderimin e serishëm të ndryshimit në pagën minimale është shumë vështirë për të ditur se cili prej indikatorëve duhet të merret parasysh dhe nëse ekziston nevoja për rishikimin e indikatorëve të tanishëm.

Kjo përmbledhje sugjeron që indikatorët duhet të jenë të uniformuar dhe që marrin parasysh të gjithë indikatorët ekonomik të shoqëruar me diskutim publik përderisa në tërësi duhet të merret parasysh hulumtimi akademik për efektet pozitive dhe negative në caktimin dhe rritjen e pagës minimale.

Përfundim

Qëllimi i kësaj përmbledhje ka qenë të ofrojë një hulumtim themelor në çështjen e pagës minimale që do të shërbente si punim diskutimi për të gjitha palët e interesuara. Punimi tenton që të qartësojë vendimin kritik të qeverisë së vitit 2011 që e paraqiti pagën minimale të parashikuar me ligj në Kosovë.

Përderisa e pranon që ka pasur hulumtime të kryera në këtë fushë, gjithashtu gjen se asnjë hulumtim apo diskutim nuk është bërë para marrjes së vendimit për caktimin e pagës minimale dhe më pastaj ekziston një hulumtim shumë i dobët lidhur me efektet e këtij vendimi.

Punimi më tepër fokusohet rreth efekteve të pagës minimale për punonjësit me përgatitje të ultë profesionale ku të rinjtë konsiderohen të jenë pjesë e saj. Përqindja e dhënë e të rinjve në tregun e punës si dhe përfundimet në këtë përmbledhje duhet ta nxisin diskutimin jo vetëm në nivelin akademik por gjithashtu edhe në nivelet e vendimmarrjes.

Shkurtimisht, përfundimet e kësaj përmbledhje janë:

- a) Qeveria nuk është angazhuar në diskutim publik para se të caktohet paga minimale e cila e sjell vendimin më tepër për të shënuar pikë politike se sa të ofrohet një asistencë për familjet e varfra.
- b) Teoritë kryesore ekonomike nuk i përkrahin pagat minimale të nivelit lartë, posaçërisht në shtetet e zhvilluara.
- c) Paga e tanishme minimale e parashikuar me ligj në Kosovë është arbitrare dhe diskriminuese pasi që vendos dy kategori të moshave që askund tjetër në botë nuk mund të gjenden përveç në Kosovë. Një

ndarje e tillë dëmton punonjësit me përgatitje të ultë profesionale që nuk hyjnë në kategorinë e të rinjve.

- d) Të dhënat prej pagës mesatare në sektorin privat nga ASK (Agjencia e Statistikave të Kosovës) tregojnë që rritja në pagën e tanishme minimale nuk do të kishte efekte të kundërta në punësim pasi që sektorët kryesorë të ekonomisë tashmë kanë rritur pagat e tyre mesatare andaj edhe përqindja e atyre që punojnë për minimumin e tanishëm mund të jetë e ultë.
- e) Ekziston nevoja për hulumtim të mëtutjeshëm për të testuar hipotezat e kësaj përmbledhjeje. Hulumtimi i tillë duhet të shoqërohet me të dhëna zyrtare dhe me studime aty ku mungojnë të dhënat zyrtare.

Bibliografia

Arpaia, A., Cardoso, P., Kiss, A., Van Herck, K., & Vandeplas, A. (2017). *Pagat minimale të parashikuara me ligj në BE: Aranzhimet Institucionale dhe Implikimet Makroekonomike*. Bon,, Gjermani: IZA – Instituti i Punës Ekonomike.

Brown, C. (1988). Ligjet e pagës minimale: A janë ato të mbivlerësuara? *Revista e Perspektivave Ekonomike* , 133-147.

Cunningham, W. V. (2007). *Pagat Minimale dhe Politika Sociale. Mësime prej Sheteve të Zhvilluara*. Vashington DC, SHBA: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim / Banka Botërore.

Danziger, L. (2007). Elasticiteti i kërkesës së fuqisë punëtore dhe paga minimale. *Springer* , 757-772.

Ellwood, D. (1988). *Përkrahja e varfër: Varfëria në familjen Amerikane*. Nju Jork, NY: Basic Books, Inc.

Gunnarsson, C., Lilja Hanson, C., & Åkerlund, I. (2006). *Kontratat Kolektive*. Paris: Cour de cassation Paris.

Organizata Ndërkombëtare e Punës. (08 qershor 2016). Organizata Ndërkombëtare e Punës. Gjetur 08 22, 2017, nga Organizata Ndërkombëtare e Punës: http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_protect/---protrav/---travail/documents/genericdocument/wcms_508566.pdf

Kellermann, K. L. (2017). *Ndikimi i Rregulloreve të Pagës Minimale në Nxitjet Arsimore për të Rinjtë. Analizat Empirike për Gjermaninë*. Münster, Gjermani: Springer Gabler.

Lavoie, M. (2006). *Paraqitja e Ekonomisë post Kejneziane*. PALGRAVE MACMILLAN.

Marginean, S., & Stefania Chenic, A. (2013). Efektet e Rritjes së Pagës Minimale: Teori, Dëshmi dhe Sfidat e së Ardhmes. *Procedia Ekonomia dhe Financat* , 96-102.

Neumark, D., & Wascher, W. L. (2008). *Pagat Minimale*. Londër, Angli: Institutut i Teknologjisë Massachusetts.

Neumark, D., & Wascher, W. L. (2007). *Pagat Minimale dhe Punësimi* (Vëll. i 3). (W. K. Viscusi, Re.) Boston: Baza dhe Trendet në Mikroekonomi.



Page, M. E., Spetz, J., & Millar, J. (2005). A ndikon Paga Minimale në Mirëqenien e Affect Welfare Caseloads? *Asociacioni për Analiza të Politikës Publike dhe Udhëheqja*, 273 - 295.



Palley, T. I. (2004). Prej Kejnesianizmit në Neoliberalizëm: Lëvizja e Paradigmave në Ekonomi. *Pluto Press*, 11.

Strategy & Development, C. (2015). *Vlerësimi i Tregut për Sektorin e Ndërtimtarisë. Perspektiva e Punësimit për të Rinjtë*. Përmirësimi i Punësimit të Rinjëve. Prishtinë: Përmirësimi i Punësimit të Rinjëve.


Van Klaveren, M., Gregory, D., & Schulten, T. (2015). *Pagat Minimale, Ujdia Kolektive dhe Zhvillimi Ekonomik në Azi dhe në Evropë. Perspektiva e Fuqisë Punëtore*. Londër, MB: PALGRAVE MACMILLAN.

Annex A – Economic Indicators in Kosovo 2010 - 2017






Economic Active Labour Rate




GDP



Net average salary in public administration



Neto average salary in private sector



TAB 14. 5: PAGA (BRUTO) MESATARE MUJORE NË SEKTORËT EKONOMIK SIPAS VITEVE 2008-2014


(€)

Sektorët	Përshkrimi i sektorëve ekonomike	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
B	Xehtari dhe gurëthyes	348	357	382	383	561	461	470
C	Prodhim	228	228	227	248	275	332	326
D	Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	486	469	555	557	564	608	610
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	197	197	210	214	219	360	361
F	Ndërtimtari	216	221	227	275	360	319	329
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve, motoçikletave	218	207	206	252	274	305	305
H	Transporti dhe magazinimi	257	260	262	263	263	366	379
I	Akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	208	217	221	220	269	266	265
J	Informacion dhe komunikim	776	783	792	829	852	707	708
L,M,N,R,S	Aktivitete të shërbimeve tjera	235	238	255	302	334	273	293
Gjithsej		275	272	280	309	338	349	352


How Kosovo compares



Kosovo and Bulgaria Unemployed Rate



Kosovo and Bulgaria GDP



Kosovo & Bulgaria Consumption per capita per capita

